

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-056/12

Prishtinë, 23 maj 2013

Në çështjen juridike të:

I.K.

Pejë/Peć

Pala ankuese

Kundër

V. D. D

Belgrade
Serbia

Paraqitësi i kërkesës/ Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/100/2011 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA20131), e datës 23 shkurt 2011, KPCC/D/A/60/2010 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA20132 dhe KPA20133), e datës 25 shkurt 2010, dhe KPCC/D/A/140/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA20134), e datës 29 shkurt 2012 pas shqyrtimit të mbajtur më 23 maj 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Anulohen vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/100/2011, i datës 23 shkurt 2011, sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numër KPA20131, vendimi KPCC/D/A/60/2010, i datës 25 shkurt 2010, sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numër KPA20132 dhe KPA20133, dhe vendimi KPCC/D/A/140/2012, i datës 29 shkurt 2012, sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numër KPA20134 ndërsa kërkesat hidhen poshtë ngase lëndët nuk janë brenda fushëveprimit të kompetencave të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës.
- 2- Obligohet pala përgjegjëse në ankesë që t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë euro) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjete) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 29 nëntor 2006, V. D. D. ka paraqitur kërkesë pranë Agjencionit Kosovar të Pronës, duke kërkuar riposedimin e pronave në vijim që gjenden në Rosuljë/Rosulje, Pejë/Peć:

Numri i ankesës dhe i lëndës së AKP-së	Të dhënat për ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-056/12 (KPA20131)	Ngastra Nr. 1/25, pyll i klasës së 3-të, në sipërfaqe prej 1 ha 68 ar 39 m ² ;
GSK-KPA-A-057/12 (KPA20132)	Ngastra Nr. 9, arë e klasës së 4të, në sipërfaqe prej 0 ha 59 ar 46 m ² ;
GSK-KPA-A-058/12 (KPA420133)	Ngastra Nr. 117, arë e klasës së 4të, në sipërfaqe prej 0 ha 28 ar 37 m ² ; Ngastra Nr. 118, arë e klasës së 4të, në sipërfaqe prej 0 ha 36 ar 96 m ² ; Ngastra Nr. 119, arë e klasës së 4të, në sipërfaqe prej 0 ha 20 ar 89 m ² ; Ngastra Nr. 120, arë e klasës së 3të, në sipërfaqe prej 0 ha 50 ar 02 m ² ;
GSK-KPA-A-59/12 (KPA20134)	Ngastra Nr. 139/1, arë e klasës së 4të, në sipërfaqe prej 0 ha 68 ar 06;

Pala përgjegjëse në kërkesë ka sqaruar se ½ e ngastrave i ka takuar babait të tij të ndjerë D. D.(gjysma tjetër R. M. D.) dhe se ai i kishte trashëguar ato. Ai ka theksuar se prona ishte humbur me 14 qershor 1999.

Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesë ka paraqitur në AKP dokumentet në vijim:

- Kopjen e Fletës Poseduese Nr. 25, të lëshuar me 13 prill 2006, nga Zyra për pronën e paluajtshme dhe Kadastër e Pejës, ku theksohet se ngastrat Nr. 1/24, 1/25, 9, 117, 118, 119, 120 dhe 139/6 ishin ½ në posedim të D. M. D. e gjysma tjetër në posedim të R.M.D.;
- Certifikata e Vdekjes, e lëshuar nga Komuna e Stari Grad-it me 30 dhjetor 2005, që vërteton vdekjen e D.D. me 2 dhjetor 2005 në Beograd, Stari Grad;
- Aktvendimin mbi trashëgimin i Gjykatës Komunale II në Beograd, O.Nr. 233/06 (i plotfuqishëm prej 19 prill 2006), me të cilin paraqitësi i kërkesës është shpallur trashëgimtar i 1/3 në ½ e pronës kontestuese [Gjykata dëshiron të theksoj se në këtë vendim ngastra Nr. 137/1 ose 139/1 (më poshtë) është e theksuar si ngastra Nr. 139/6].

Zyrtarët e AKP-së kanë gjetur Fletën Poseduese të UNMIK-ut me Nr. 25, të lëshuar nga Agjensioni Kadastral i Kosovës me 27 maj 2008, që tregon se ngastrat kontestuese ishin të regjistruara si ½ në emër të D.M.D., e gjysma tjetër në emër të R.M. D.. Gjykata dëshiron të shtoj se në këtë fletë ara në sipërfaqe prej 68 ari e 06 m² është e regjistruar si ngastra Nr. 137/1 [e jo 139/1 sikurse në fletën poseduese të vitit 2006, që është dorëzuar nga paraqitësi i kërkesës dhe 139/6 në Fletën Poseduese të vitit 1978 të dorëzuar nga Paraqitësi i ankesës më vonë gjatë procedurës]. Certifikata e vdekjes dhe Aktvendim i trashëgimisë janë verifikuar po ashtu.

Për lëndët GSK-KPA-A-057/12 (KPA20132) dhe GSK-KPA-A-058/12 (KPA20133), zyrtarët e AKP-së në nëntor të vitit 2009 kanë shkuar tek vendet kur pretendohej se gjendeshin Ngastrat Nr. 9, 117, 118, 119 dhe 120, dhe në secilën ngastër kanë vendosur shenjen e njoftimit dhe duke njoftuar se kushdo që pretendon se ka të drejtë në ngastër mund të paraqitet dhe të marr pjesë në procedurën pranë AKP-së. Njoftimet më vonë u kontrolluan në bazë të Planit Kadastral, Aerografisë, dhe Koordinatave të GPS dhe u vërtetua se ishin në rregull.

Përderisa askush nuk është përgjigjur në kërkesë, KKPK-ja me 25 shkurt 2010 përmes vendimit të saj KPCC/D/A/60/2010 ka vendosur që paraqitësi i kërkesës në këto lëndë ka vërtetuar se ai është pronari i 1/6 pjesë së pronës së kërkuar dhe ka të drejtën në posedimin e kësaj prone.

Me 24 shtator 2010 AKP-ja ka bërë njoftimin publik në lidhje me kërkesën KPA20131 (GSK-KPA-A-56/2012) dhe kërkesën KPA20134 (GSK-KPA-A-059/12) duke e publikuar të njëjtën në Gazetën e Njoftimeve të AKP-së Nr. 9 si dhe në Buletinin e Zyrës së Pronës së UNHCR. Gazetën dhe Listën e lanë tek udhëheqësi i fshatit dhe u vendosen në hyrje dhe dalje të Rosuljë dhe u shpërndan tek disa zyrtarë të shumtë.

Përderisa edhe në këto raste askush nuk është përgjigjur ndaj kërkesës, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës me 23 shkurt 2011 përmes vendimit KPCC/D/A/100/2011 ka vendosur se paraqitësi i kërkesës ka vërtetuar se ai ka qenë pronari i $\frac{3}{4}$ të ngastrës së lartcekur Nr. 1/25 (KPA20131; GSK-KPA-A-56/12) dhe ka të drejtën e posedimit të saj. Sa i përket kërkesës KPA20134 (GSK-KPA-A-59/12), KKPK-ja me vendimit e vetë KPCC/D/A/140/2012 të datës 29 shkurt 2010, ka vendosur se paraqitësi i kërkesës e kishte vërtetuar se ai ishte pronari i 1/6 të pronës së kërkuar dhe me të drejtën e posedimit të saj.

I.K.(pala ankuese) me 2 prill 2012 paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme. Ai shpjegoi se e kishte blerë pronën kontestuese përmes kontratës së datës 25 tetor 1978, të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Pejës, Vr.Nr. 2362/78. Ai ka deklaruar se ai kishte pritur që Gjykata do ta kishte regjistruar pronën në emër të tij dhe se kësaj nuk i kishte kushtuar vëmendje më tutje. Në mbështetje të pretendimeve të tij ai i ka siguruar Gjykatës Supreme në mes tjerash edhe kopjen e kontratës së shitblerjes përmes së cilës R.D., i përfaqësuar nga V.P., dhe D. D., i përfaqësuar nga Z.D., ia kanë shitur ngastrat kontestuese (ose nga një pjesë ideale të gjysmës të secilës ngastër, kontrata për këtë mbetet e paqartë) I.K. nga Qellopek/Celopek.

Paraqitësi i kërkesës (tutje si: pala përgjegjëse në ankesë) ka pranuar ankesën me 7 gusht 2012, megjithatë ai nuk është përgjigjur.

Me vonë në procedurë pala ankuese ka shpjeguar se ai nuk ka qenë në dijeni të kërkesës ngase ai nuk ka jetuar në Rosuljë, ku gjenden ngastrat por në Qellopek/Celopek.

Me 8 mars 2013 palës përgjegjëse në ankesë i është dërguar një urdhër nga Gjykata Supreme, duke kërkuar prej tij që të shpjegoj brenda dy javësh prej datës së pranimit të këtij urdhrit, se në çfarë

mënyre lidhet humbja e pronës me konfliktin e armatosur në Kosovë në vitet 1998/1999 dhe e ka paralajmëruar se nëse nuk përgjigjet ai do ta mund të humb rastin. Megjithatë pala përgjegjëse në ankesë nuk është përgjigjur.

Gjykata Supreme i ka bashkuar lëndët.

Arsyetimi i ligjor:

Ankesa është e pranueshme edhe pse pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurë pranë AKP/KKPK-së.

Në lidhje me lëndët GSK-KPA-A-56/2012 (KPA20131) dhe GSK-KPA-A-059/12 (KPA20134) njoftimi i kërkesave ishte bërë me publikimin e kërkesave në Gazetën e Njoftimeve të AKP-së dhe Buletinin e UNHCR-it. Kjo, megjithatë, përbën “përpyetje të arsyeshme” ashtu siç kërkohet me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079 vetën në rrethana të veçanta. Këtu veçanti të tillë nuk ka. Përderisa gjykata nuk mund të përjashtoj se pala ankuese nuk ka qenë në dijeni për kërkesat, ai duhet të pranohet si palë në procedurë, ankesa e tij është e pranueshme.

Sa i përket lëndëve GSK-KPA-A-057/12 (KPA20132) dhe GSK-KPA-A-058/12 (KPA20133), pala ankuese ka sqaruar se ai nuk parë ndonjë njoftim ngase ai nuk jeton në fshatin kur janë të vendosura ngastrat. Gjykata e ka pranuar këtë sqarim, po ashtu në këto lëndë ankesa e I.K. është e pranueshme.

Edhe pse KKPK-ja si organ gjysmë-gjyqësor duke vendosur mbi meritat e kërkesës tashme e ka pranuar kompetencën e vetë, Gjykata *ex officio* e vlerëson nëse rasti bie në fushëveprimin e kompetencave të saj (Neni 195.1 b, e Ligjit të Procedurës Kontestimore).

Prandaj, vendimet e KKPK-së për aq sa janë ankimuar është dashtë të anulohen dhe kërkesat të hidhen poshtë (Neni 11.4 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, jo të refuzohet.

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka ta drejtë në urdhër nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm të drejtën në prone por edhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato

të drejta pronësore sipas rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.

Megjithatë, në këto raste, pala përgjegjëse në ankesë nuk i ka siguruar Gjykatës ndonjë fakt që do mund të shpie tek përfundimi se humbja e pronës është e lidhur drejtpërdrejt me konfliktin e armatosur. Në rastet kur gjykata ka indikacione se paraqitësi i kërkesës ose familja e tij kishin ikur nga Kosova ose kanë lënë pronat e tyre për shkak të konfliktit të armatosur, Gjykata zakonisht supozon se humbja e pronës lidhet me konfliktin e armatosur. Megjithatë, këtu nuk ka indikacione të tilla. Sipas formës së kërkesës, pala përgjegjëse në ankesë ka lindur në vitin 1982 në Beograd. Gjykata supozon se e tërë familja në këtë kohë ishin duke jetuar në Beograd dhe për këtë ata nuk janë larguar nga pronat e tyre në Kosovë për shkak të konfliktit të armatosur. Edhe pse gjykata ka lëshuar urdhër, i cili në mënyrë të shprehur ka kërkuar informacione se në cilën mënyrë ndërlidhej humbja e pronës me konfliktin si dhe paralajmërimin ndaj paraqitësit të kërkesës që nëse ai nuk do ta respektonte urdhrin ai do ta humbiste rastin, pala përgjegjëse në ankesë nuk është përgjigjur. Pa ndonjë informacion tjetër, gjykata, megjithatë, nuk mund të konsideroj se humbja e pronës të jetë e lidhur drejtpërdrejt me konfliktin e armatosur në Kosovë në vitet 1998/1999.

Prandaj, lëndët nuk janë brenda kompetencave të KKPK-se e as të Kolegjit të Apelit të AKP-së.

Rrjedhimisht vendimi i KKPK-së në lidhje me kërkesën është dashtë të anulohen dhe kërkesa të hidhet poshtë si jashtë kompetencave të KKPK-së dhe Gjykatës.

Gjykata thekson se ky vendim nuk e cenon të drejtën e palës përgjegjëse në ankesë që të i ndjek kërkesat e tij pranë gjykatës kompetence civile (Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079).

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksave gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit. Kështu që, taksat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10,11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit, përderisa vlera e pronës kontestuese mund të vlerësohet më shumë se 10.000 € (10.21, 10.15 dhe 10.1 të UA 2008/20); 30 .

Këto taksa gjyqësore duhet të merren përsipër nga Pala përgjegjëse në ankesë e cila ka paraqitur kërkesë të papranueshme. Sipas nenit 46 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, kur një person me vendbanim jashtë vendit është i obliguar të paguaj një taksë, afati për pagesën e saj nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë dhe as më i gjatë se 90 ditë. Gjykata vendos se afati në këtë rast është 90 (nëntëdhjetë) ditë. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk paguan taksën brenda afatit, pala do të duhet të paguaj një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk e paguan taksën në afatin e dhënë, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

Udhëzim juridik

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe ato jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Ermenova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it